



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

KESHILLI BASHKIAK

Nr. 9435 / 12 .Prot

Bajram Curri me 31 .12 .2024

VENDIM

Nr. 101 Date. 24.12.2024

**“MBI MIRATIMIN E KALENDARIT TE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026”.**

Këshilli i Bashkisë Tropojë në mbledhjen e tij të datës 24.12.2024 me propozimin e kryetarit të bashkisë, në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1/1.1, shkronja “b”, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 54 shkronja “dh” dhe neni 55 pika 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji nr.44/2015 I ndryshuar, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 6, 15, 17, 32 i Ligjit nr. 9936, datë 28.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; neni 6, shkronjat “ç” dhe “d”, neni 33, neni 40, neni 41, pika 1 dhe 3 të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin; Udhëzimit nr.10 datë 27.02.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm”; Shkreses Nr 14488 prot date 29.10.2024 e Ministrise se Financave,

VENDOSI:

1.Te miratoje Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor ,2026 si me poshte:

<i>Nr</i>	<i>Aktivitetet e Projekt Buxhetit afatmesem 2025-2027</i>	<i>Personat pergjegjes</i>	<i>Afati</i>
<i>1</i>	Keshilli i Bashkise Tropoje miraton Kalendarin per pregatitjen e PBA-se 2026-2028 dhe Projektbuxhetit Vjetor 2026	Kryetari Bashkise Tropje	Deri me 31 Dhjetor 2024 ¹
<i>2</i>	Pregatitja e raportit vleresues paraprak te te ardhurave per periudhen 2026-2028	Spektori i tatim taksave	Deri me 31 Janar 2025 ¹
<i>3</i>	Miratimi i Raportit te parashikimit te te ardhurave per periudhen 2026-2028	Spektori I tatim taksave	Deri me 1 Mars 2025 ²

¹ Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave ,pika 2 e nenit 34 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

² Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave jo më vonë se data 1 mars, pika 4 e nenit 34 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

4	Pregatitja dhe miratimi ne Keshillin e Bashkise Tropoje te tavanave pregatitore per secilin program buxhetor.	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve	15 Mars 2025 ³
5	Perpilimi i Udhezimit te Brendshem per pregatitjen e PBA-se me tavanet buxhetore te miratuara per cdo program,manualin shpjegues,pasqyrat per plotesim nga EMP-ja per kerkesat buxhetore.	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve,dhe Drejtorite perkatese	20 Mars 2025 ⁴
6	Plotesimi i kerkesave buxhetore te konsoliduara per cdo program,dhe kerkesave shtese sipas programeve nga drejtueit e EMP-ve.	Ekipete e Menaxhimit te Programeve/Drejtorite dhe Sektoret perkate.	25 Mars 2025 ⁵
7	Vleresimi dhe miratimi nga Grupi per Menaxhim strategjik i kerkesave e buxhetore te paraqitur nga Ekipet e Menaxhimit te Programeve	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve	15 Maj 2025 ⁶
8	Hartimi i Draft-Dokumentit te PBA-se 2026-2028 dhe dergimi ne Ministrine e Financave ,sipas formateve te derguara nga Ajo.	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve dhe Kryetari i Bashkise	Deri me 1 qershor 2025 ⁷
9	Shqyrtimi i rekomandimeve per Draft PBA-ne dhe pregatitja e nje opiniononi ne lidhej me rekomandimet e MF.Draft i Pba-se ,rekomandimi perkates dhe vleresimi i rekomandimeve ,paraqiten per miratim ne keshill	Kryetari i Bashkise dhe Grupi per Menaxhim Strategjik.	Deri me 30 Qershor 2025 ⁸
10	Projekt Buxheti Afatmesem 2026-2028 i miratuar dergohet ne menyre elektronike dhe zyrtarishte ne Ministrine e Financave	Kryetari i Bashkise dhe Grupi per Menaxhim Strategjik.	30Qershor 2025 ⁹

³ Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm jo më vonë se data 15 mars, pika 6 e nenit 34 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

⁴ Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tavanave përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm,

kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese, pika 1 e nenit 35 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

⁵c) afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm pika c e nenit 35 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

⁶ afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm pika c e nenit 35 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore.

⁷ Brenda datës 1 qershor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i dërgon Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm. pika 6 e nenit 36 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

⁸ Brenda datës 30 qershor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm, duke shprehur edhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave. . pika 8 e nenit 36 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

⁹ Po aty pika 8 ,neni 36

11	Publikimi i Dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesem 2026-2028,te miratuar	Kryetari I Bashkise dhe Grupi per Menaxhim Strategjik.	5 Korrik 2025 ¹⁰
12	Miratimi ne Keshillin e Bashkise te tavanave pefundimtare te shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem ne nivel programi	Kryetari I Bashkise dhe Grupi per Menaxhim Strategjik.	20 Korrik 2025 ¹¹
13	Udhëzim i brendshem ,me tavanet perfundimtare te shpenzimeve ne nivel programi dhe fatet e pregatitjes se kerkesave te rishikuara te shpenzimeve te programit buxhetor aftamesem	Kryetari I Bashkise dhe Grupi per Menaxhim Strategjik.	25 Korrik 2025 ¹²
14	Finalizimi i dokumentit te Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028 i rishikuar dhe publikimi i tij	Kryetari I Bashkise dhe Grupi per Menaxhim Strategjik.	Gusht 2025 ¹³
15	Degjesat Publike ne lidhje me Projekt Buxhetin afatmesem 2026-2028	Kryetari i Bashkise	Gusht-Shtator 2025 ¹⁴
16	Bashkia Tropoje dergon ne ne Ministrine e Financave Dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesem te rishikuar,te miratuar nga Keshilli I Bashkise,se bashku me nje informacion mbi rekomandimet e dhena nga Ministria e Financave gjate fazes se pare te hartimit te PBA-se.	Kryetari i Bashkise dhe Grupi per Menaxhim Strategjik.	15Shtator 2025 ¹⁵
17	Zhvillimi i seancave te konsultimit publik dhe reflektimi i sugjerimeve ne Dokumentin Final te PBA-se	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit te Programeve dhe Kryetari i Bashkise	5 Tetor 2025 ¹⁶

¹⁰ Kryetari i njësise së vetëqeverisjes vendore merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik. . pika 9 e nenit 36 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

¹¹ Këshilli i njësise së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik. . pika 1 e nenit 37 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

¹² Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të tavanave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, kryetari i njësise së vetëqeverisjes vendore nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësise së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitet shpenzuese, . pika 2 e nenit 37 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

¹³ Pas marrjes së udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit, kryetari i njësise së vetëqeverisjes vendore nis menjëherë punën për përgatitjen e projektit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm . pika 1 e nenit 38 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

¹⁴ Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësise së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interes . pika 2 e nenit 38 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”


¹⁵ . Brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësise, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së pare . pika 3 e nenit 38 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

¹⁶ Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitet e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor . , pika 4 e nenit 38 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore


18	Pregatitja e Dokumentit final te Projekt Buxhetit afatmesem dhe Projekt Buxhetit vjetor dhe paraqitja per shqyrtim dhe miratim ne Keshill.	Kryetari i Bashkise	30 Nentor 2025 ¹⁷
19	Miratimi i Dokumentit te Projekt Buxhetit Afatmesem 2026-2028 ,perfundimtar dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2026	Keshilli i Bashkise Tropoje	25Dhjetor 2025 ¹⁸
20	Publikimi i dokumentit te Projekt Buxhetit Afatmesem 2026-2028 ,perfundimtar dhe Projekt Buxhetit Vjetor 2026	Kryetari i Bashkise	31Dhjetor 2025 ¹⁹

2.Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

SEKRETARI
Ergent GJONGECAJ



KRYETARI
Arber ÇAKRAJ



Shpallur me 30.12.2024

Miratuar me 11 vota

Vota Pro 11

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

¹⁷ Pas marrjes së mendimeve përfundimtare nga Ministria e Financave dhe bashkërendimit me projektbuxhetin vjetor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit projektin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe e paraqet për shqyrtim e miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, së bashku me projektbuxhetin vjetor, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor , pika 1 e nenit 39 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

¹⁸ Projekti i programit buxhetor afatmesëm përfundimtar miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor. , pika 2 e nenit 39 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

¹⁹ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për të publikuar dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre, jo më vonë se data 31 dhjetor. , pika 3 e nenit 39 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore